

The background of the cover is a photograph of an airplane's wing and tail section, viewed from a high angle. The sky is filled with soft, white clouds. A semi-transparent blue rectangular box is overlaid on the middle of the image, containing the title and subtitle text.

RAPORT

Rezultatet e anketës mbi ndikimin e mundshëm të liberalizimit të vizave në tregun e punës në Kosovë

Prishtinë, Korrik 2023

Përmbajtja

3	Hyrje
4	Metodologjia
5-18	Analiza e të dhënave
19	Përfundimi
20	Mirënjohje

Hyrje

Kosova, si shteti më i ri në Evropë, që nga 2008 po vijon me hapa të sigurtë rrugëtimin e saj në aspiratat për anëtarësimin në BE. Më 18 Prill, Parlamenti Evropian miratoi vendimin final për liberalizimin e vizave. Qytetarët e Kosovës do të lëvizin të lirë në Evropë nga 1 Janari i vitit 2024.

Në pritje të liberalizimit të vizave në vitin e ardhshëm, lind nevoja për të menduar në mënyrë kritike se çfarë do të sjellë për kushtet ekonomike dhe sociale ky zhvillim. Në pamje të parë mendohet që liberalizimi i vizave do të jetë destinacioni i shumë kërkuar në rrugën e suksesit, por në një zhvillim të tillë nuk duhet anashkaluar fakti që Kosovës do t'i duhet të përballet me sfida të rëndësishme në rrafshin ekonomik, social dhe politik. Një nevojë e pashmangshme do të jetë përgatitja paraprake për të parashikuar se çfarë ndryshimi do të sjellë liberalizimi i vizave, veçanërisht në tregun e punës.

The Headhunter Karriera LLC – Kosovë, si një nga kompanitë lider në fushën e punësimit, ka kryer një studim hulumtues mbi perceptimin e qytetarëve të Kosovës në lidhje me ndikimin e liberalizimit të vizave në tregun e punës në Kosovë. Ky studim është përgatitur në bashkëpunim me studentët e Kolegjit "Pjetër Budi".

Studimi kishte për qëllim të kuptonte rreziqet dhe përfitimet e mundshme të liberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian (BE) në tregun e punës në Kosovë. Përmes kësaj ankete janë analizuar mendimet e të anketuarve mbi ndikimin e mundshëm të liberalizimit të vizave në tregun e punës, si dhe shqetësimet e tyre lidhur me mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar, zbatimin e ligjit të punës dhe qasjen e punëdhënësve ndaj punëtorëve.

Në këtë hulumtim, u mbledhën të dhëna demografike për të anketuarit, duke përfshirë nivelin e arsimimit, moshën, profesionin dhe vendndodhjen e tyre. Këto të dhëna kanë ndihmuar në krijimin e një pamje të plotë të ndikimit të mundshëm të liberalizimit të vizave në grupet e ndryshme të popullatës në Kosovë.

Rezultatet e këtij hulumtimi do të shërbejnë si një bazë e rëndësishme për hartimin e politikave të përshtatura për nevojat dhe rrethanat specifike të grupeve të ndryshme brenda tregut të punës në Kosovë. Studimi do të ndihmojë institucionet e ndryshme shtetërore si dhe bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha për të projektuar hapat e mëtejshëm që duhet të ndërmerren në menaxhimin e situatave që do të krijohen në fushën e punësimit në të ardhmen.

Kjo do të ndihmojë në sigurimin e një integrimi sa më të mirë ekonomik dhe shoqëror me vendet e Bashkimit Evropian, duke përmirësuar kështu përfitimet dhe reduktuar rreziqet e mundshme në këtë proces.

Një përshkrim i plotë i rezultateve të hulumtimit do të gjendet në web faqen e The Headhunter Karriera LLC (www.theheadhunter.com), prezantimi i rezultateve në [Kiko këtu](#) si dhe në web faqen zyrtare të Kolegjit 'Pjetër Budi' (www.pjeterbudi-edu.com). Gjithashtu, rezultatet do të ndahen me të gjitha palët e interesuara.

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për këtë raport është bazuar në zhvillimin e pyetësorit elektronik përmes platformës SurveyMonkey, duke përfshirë akter të ndryshëm si profesor universitar, hulumtues, njohës të fushës dhe studentë.

Pyetësi përfshin gjithsej 27 pyetje të ndara në 5 seksione të ndryshme, i cili është shpërndarë në mënyrë të elektronikës për të grumbulluar të dhënat nga pjesëmarrësit e interesuar.

Në këtë studim morën pjesë gjithsej 1433 persona, ndërsa 1207 prej tyre kanë plotësuar anketën në tërësi me shkallë të përgjigjes prej 84.2%.


Pas mbarimit të periudhës së mbledhjes së të dhënave, të gjitha përgjigjet e grumbulluara janë shqyrtuar dhe analizuar me kujdes. Procesi i analizës përfshinë vlerësimin e përgjigjeve për secilën nga pyetjet dhe për secilën seksion të pyetësorit.

Gjithashtu, është kryer edhe analizë demografike për të përcaktuar përfaqësimin e grupmoshave të të anketuarve në raport. Ky proces i analizës ka qenë i drejtuar nga synimi për të identifikuar trende, tendenca dhe marrëdhënie të ndryshme mes të dhënave të grumbulluara.

Analiza e të dhënave

Gjetjet e këtij hulumtimi janë të bazuara në të dhënat të dalura nga anketimi i 1433 personave pjesëmarrës, ku nga përgjigjet e marra rrjedhin rezultatet e mëposhtme.

Q1 Cila është moshë juaj? 1,433



Në këtë studim morën pjesë 1433 persona, ku rreth 50% e të anketuarve i takonin moshës 25-34 vjeç, 26% prej tyre ishin të moshës 35-44 vjeç dhe rreth 16% të moshës 18-24 vjeç. Tri grupmoshat me më pak përfaqësim ishin 45-54 me 7%, 55-64 me 1% dhe nën moshën 18 vetëm 0.3% e të anketuarve. Nuk kishte asnjë të anketuar mbi moshën 64 vjeçare.

Q2 Cila është gjinia juaj? 1,433




Nga të anketuarit, rreth 64% prej tyre janë meshkuj ndërsa 36% femra.

Q3

Unë jetoj në:

1,433




Rreth 89% kanë deklaruar që jetojnë në qytet, kurse 11% pohojnë që jetojnë në fshat.

Q4

Në cilin regjion jetoni?

1,433




Shumica e të anketuarve (70%) janë banorë të Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër janë nga 6 regjionet kryesore të Kosovës. Nga regjioni i Ferizajit dhe Gjilanit, kishte numër të përafërt të të anketuarve, me 6.8% dhe 6.6%. Mitrovicë dhe Prizren me nga 5.5% dhe Gjakovë dhe Pejë me nga 3%.

Q5

Cili është niveli juaj më i lartë arsimimit të përfunduar?

1,433




Sipas të dhënave nga ky studim, shumica kanë të mbaruar nivelin bachelor (53%), të ndjekur nga ata me nivelin master (33%). Me arsimim të mesëm 9% ndërsa me doktoraturë vetëm rreth 2%. Vetëm 7 persona deklaruan që kanë përfunduar vetëm shkollën fillore ndërsa rreth 3% kanë zgjedhur opsionin "Tjetër".

Q6

Cili është profesioni juaj aktual?

1,433




Në pyetjen "Cili është profesioni juaj aktual" mbizotëron profesioni IT dhe Telekomunikim me 36%. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (24%) ishin të një profesioni tjetër nga opsionet e ofruara në anketë. Në Banka dhe Sigurime ishin rreth 11%, Shërbime profesionale, shkencore dhe teknike të përfaqësuar me 9%, Tregti me shumicë dhe pakicë me 5%, ndërsa profesionet e tjera të ofruara si zgjedhje përbëjnë përqindjen rreth 14%.

Q7

Cili është statusi juaj aktual i punësimit?

1,433




Shumica dërrmuese e të anketuarve deklaruan që janë të punësuar me orar të plotë (81%), të ndjekur nga të vetëpunësuarit (8%) dhe të papunët (7%). Me orar të shkurtër të punës ishin 2% ndërsa të papunë por që nuk janë në kërkim të ndonjë vendi pune u deklaruan vetëm 1%.


Q8

Sa janë të hyrat e juaja mesatare mujore?


1,290




Me mbi 800 Euro të ardhura mujore ishin 71% e pjesëmarrësve në këtë hulumtim. Një përqindje prej 17% rezultojnë të kenë mbi 500 por më pak se 800 Euro të hyra mujore. Me 300-500 Euro të hyra u deklaruan 9% ndërsa vetëm 2% kanë më pak se 300 Euro të hyra mujore.



Nga të papunësuarit, arsyeja kryesore e theksuar ka qenë pamundësia për të gjetur punë (48% e të anketuarve). Duke ndjekur shkollim apo trajnime ishin 26%, që rezulton si arsyeja e dytë më e zgjedhur. Përgjegjësitë familjare apo arsyet shëndetësore me nga 8%, respektivisht me 2%. Arsye të ndryshme nga zgjedhjet e cekura më lartë kishin 17% e pjesëmarrësve.



Duke kërkuar punë në mënyrë aktive ishin 52% e të papunësuarve. Rreth 18% prej tyre nuk ishin në kërkim të punës momentalisht ndërsa duke kërkuar punë për një periudhë 6-12 muaj ishin 13% e të papunësuarve. Nga 1-2 vjet u shprehën 11% ndërsa me 2-5 vjet dhe me mbi 5 vjet rreth 3% e të anketuarve.



Me 500-1000 Euro të ardhura mujore ishin 36% e familjeve të të papunësuarve në këtë hulumtim. Një përqindje prej 26% rezultojnë të kenë rreth 500 Euro të hyra familjare mujore. Me 1000-1500 Euro të hyra në familje u deklaruan 23% ndërsa 15% e pohuan që kanë mbi 1500 Euro të hyra mesatare mujore në familjet e tyre.


Qëllimi	Sasia	Sasia në %	% sipas respondentit
Turizëm	857	37.26%	71.00%
Vizitë familjare	497	21.61%	41.18%
Për Biznes	383	16.65%	31.73%
Për të gjetur punë	340	14.78%	28.17%
Për Studime	185	8.04%	15.33%
Tjera	38	1.65%	3.15%

Arsyeja kryesore e udhëtimit në vendet e BE rezulton të jetë Turizmi(37%), me vizitat familjare si arsyeja e dytë më e zgjedhur(22%). Për Biznis ose për të gjetur punë u deklaruan 17%, respektivisht 15% e respondentëve. Studimi në vendet e BE është qëllimi i udhëtimit për 8% ndërsa arsye tjetër nga zgjedhjet e cekura kishin rreth 2% e pjesëmarrësve në këtë hulumtim.

Q13

Unë do të udhëtoj në BE pas liberalizimit të vizave:

1,207




Që do të udhëtojnë në BE brenda 3 muajve të parë pas liberalizimit të vizave u shprehën 34%, njejtë me përqindjen e të pasigurtëve për kohën kur do të udhëtojnë në BE. Që do të udhëtojnë brenda 6 muajve pas liberalizimit të vizave mendojnë 18% e të anketuarve ndërsa 14% e tyre thanë që do të udhëtojnë brenda një viti.

Q14

A do të jetë kjo hera e parë që ju do të udhëtoni në një vend të Bashkimit Evropian (BE)?

1,207




Sipas këtij hulumtimi rreth 79% e të anketuarve kanë udhëtuar edhe me herët jashtë vendit, ndërsa 21% do të udhëtojnë për herë të parë në vendet e BE-së.

Q15

A keni vërejtur ndonjë ndryshim në mundësitë e punësimit që nga njoftimi zyrtar për liberalizimin e vizave për Kosovën?

1,207




Sipas 51% e pjesëmarrësve në këtë anketë nuk është vërejtur ndonjë ndryshim për mundësi të punësimit që nga njoftimi për liberalizimin e vizave, ndërsa 27% kanë deklaruar që ka më shumë mundësi pune, 20% janë nuk kanë qenë të sigurtë dhe 1% kanë deklaruar se kanë vërejtur më pak mundësi pune.

Q16

A keni menduar të gjeni punë jashtë vendit që kur u dha njoftimi zyrtar i liberalizimit të vizave për Kosovën?

1,207




Sipas të dhënave nga kjo anketë 66% të anketuarve nuk kanë menduar të gjejnë punë jashtë vendit që kur është dhënë lajmi për liberalizimin e vizave për Kosovën, ndërkohë rreth 34% kanë pohuar që kanë menduar të gjejnë vende të punës në vendet e BE-së.

Q17

Nëse i jeni përgjigjur "po" pyetjes së mëparshme, në cilat vende keni menduar të punoni?

529




Nga 34% e të anketuarve që kanë deklaruar se kanë menduar të gjejnë punë në vendet e BE-së, rreth 70% deklaruan se destinacion i tyre do të jetë Evropa Qendrore-Perëndimore, 17% preferojnë vendet Nordike, 7% do punonin në Evropën Veriore-Lindore. Në Evropën Qendrore-Lindore do të punonin 2%, ndërsa Portugalinë, Spanjën dhe vendet Baltike për të punuar i kanë zgjedhur më pak se 1% e të anketuarve.

Q18

A besoni se liberalizimi i vizave me Bashkimin Evropian (BE) mund të ketë ndikim në tregun e punës në Kosovë?

1,207




Se liberalizimi i vizave mund të ketë ndikim në tregun e punës në Kosovë kanë deklaruar afër 80% e të anketuarve, ndërsa rreth 19% deklaruan se mund të ketë ndikim por jo të dukshëm. Afër 2% deklaruan se nuk mendojnë që mund të ketë ndonjë ndikim.

Q19

A besoni se tregu i punës në Kosovë mund të konkurrojë me tregun e punës në vendet e tjera evropiane pas një viti?

1,207




Sipas 32% e të anketuarve kanë deklaruar së tregu i punës në Kosovë mund të konkurrojë me tregun e punës në vendet e tjera evropiane, por 47% mohuan që Kosova mund të konkurrojë më tregun evropian dhe 20% u shprehen se nuk e dinë.

Q20

A mendoni se liberalizimi i vizave do të ua lehtësojë qytetarëve të Kosovës gjetjen e punës jashtë vendit?

1,207




Se liberalizimi i vizave do të ua lehtësoj qytetarëve të Kosovës gjetjen e punës jashtë vendit kanë pohuar rreth 80% e të anketuarve, 10% mohuan ndërsa 9% u shprehën që nuk janë të sigurtë.

Q21

A dëshironi të migroni në një vend evropian në të ardhmen e afërt?

1,207



Reth 41% e të anketuarve kanë mohuar që dëshirojnë të migrojnë jashtë vendit në një të ardhme të afërt, 26 % kanë pohuar ndërsa 33% nuk janë të sigurtë.

Q22

Nëse keni menduar të migroni në një vend tjetër evropian, cila është arsyeja kryesore?


1,207

Arsyeja kryesore	Sasia	Sasia në %	% sipas respondentit
Cilësi më të lartë të jetës	782	36.96%	64.79%
Mundësi më të mira pune	469	22.16%	38.86%
Mundësi më të mira arsimimi	369	17.44%	30.57%
Tjera	195	9.22%	16.16%
Arsye familjare	176	8.32%	14.58%
Arsye politike apo sociale	125	5.91%	10.36%

Cilësia më e lartë e jetës është arsye psë 37% e të anketuarve kanë deklaruar së do të migronin jashtë vendit, 22% deklaruan së mundësitë më të mira të punës i shtyejnë të mendojnë të migrojnë në të ardhmen. Përderisa 17% si arsye kryesore e shohin mundësitë më të mira të arsimit, për arsye familjare do të migronin 8%, ndërsa për arsye politike apo sociale do të migronin 16% dhe për arsye të tjera u shprehen 9%.

Ndikimi	Sasia	Sasia në %	% sipas respondentit
Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar në Kosovë	820	24.20%	67.94%
Largimi i trurit (Brain drain), pasi punëtorët me kualifikim të lartë largohen për mundësi më të mira pune në BE	719	21.22%	59.57%
Rritja e pagave dhe përfitimeve për puntorët në Kosovë	708	20.90%	58.66%
Forcohet zbatimi i ligjit të punës në Kosovë	425	12.54%	35.21%
Zvogëlimi i konkurrencës për vende pune	411	12.13%	34.05%
Rritja e konkurrencës për vende pune	267	7.88%	22.12%
Tjera	24	0.71%	1.99%
Ulje e pagave dhe përfitimeve për puntorët në Kosovë	14	0.41%	1.16%


Sipas 24% e të anketuarve mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar në Kosovë mund të jetë ndikimi që mund të krijojë liberalizimi i vizave në tregun e punës në Kosovë. Largimi i trurit (brain drain), pasi punëtorët me kualifikim të lartë largohen për mundësi më të mira pune në BE, shihet si arsye nga 21% e të anketuarve. Ndikim liberalizimi i vizave sipas 20% e të anketuarve mund të ketë edhe në rritjen e pagave dhe përfitimeve për punëtorët në Kosovë, po ashtu 12% e mendojnë që me liberalizimin e vizave mund të forcohet zbatimi i ligjit të punës në Kosovë. Rreth 13% mendojnë që me liberalizimin e vizave do të zvogëlohet konkurrenca për vendet e punës, krahas tyre 8% mendojnë që do të rritet konkurrenca për vende të punës ndersa me pak se 1% mendojnë që do të ketë ulje të pagave dhe përfitimeve për punëtorët në Kosovë.




Një përqindje prej 43% e të anketuarve u shprehën optimist që liberalizimi i vizave do të ndikoj në përmirësimin e kushteve të punës për punëtorët në Kosovë, kurse 49% u shprehën deri diku optimist dhe 7% u shprehën jo optimist.

Qasja e punëdhënësve	Sasia	Sasia në %	% sipas respondentit
Trajtimi më i mirë i punëtorëve për shkak të rritjes së ofertës së punës	812	35.85%	67.27%
Rritja e konkurrencës për fuqi punëtore të kualifikuar, duke cuar në paga më të larta dhe kushte të përmirësuara të punës	710	31.35%	58.82%
Përmirësim i kushteve të punës të ofruara nga punëdhënësi për shkak të rritjes së numrit të kompanive të BE-së që investojnë në Kosovë	508	22.43%	42.09%
Shfrytëzimi më i madh i punëtorëve për shkak të mungesës së fuqisë punëtore	215	9.49%	17.81%
Tjera	20	0.88%	1.66%

Trajtimi më mirë i punëtorëve për shkak të rritjes së ofertës së punës shihet si arsye që 36% e të anketuarve e mendojnë se liberalizimi i vizave do të ndikoj në qasjen e punëdhënësve në Kosovë. Afërsisht 31% mendojnë që ndikimi i liberalizimit do të jetë rritja e konkurrencës për fuqi punëtore të kualifikuar, duke bërë që të ketë paga më të larta dhe kushte të përmirësuara të punës. Përmirësimi i kushteve të punës së ofruara nga punëdhënësi për shkak të rritjes së numrit të kompanive të BE-së që investojnë në Kosovë është zgjedhur nga 22% dhe 9% konsiderojnë që do të ketë shfrytëzim më të madh të punëtorëve për shkak të mungesës së fuqisë punëtore.



Të vetëdijshëm për rregullat e udhëtimit pa viza dhe qëndrimin afatshkurtër në BE u shprehën 65% e të anketuarve. Që kanë disa njohuri u shprehën 28% dhe që nuk kanë njohuri për këto rregulla u shprehën 7%.



Mbi 79% e të anketuarve janë të informuar që qytetarët e Kosovës nuk mund të punojnë në vendet e BE-së pa viza, 16% shprehën të pa sigurt kurse 4% mendojnë që mund të punohet në vendet e BE-së pa viza.

Përfundimi

Bazuar në të dhënat e paraqitura në këtë studim, mund të dalin disa përfundime lidhur me ndikimin e liberalizimit të vizave në tregun e punës në Kosovë:

Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë mbaruar studimet në nivelin bachelor dhe janë të punësuar me orar të plotë. Kjo tregon për një nivel të lartë të arsimimit dhe një treg pune relativisht stabil në vend.

Profesionet e njohura si IT dhe Telekomunikacioni janë të përzgjedhura më shpesh nga të anketuarit, ndërsa pjesa tjetër shkon në industri të ndryshme si Banka, Sigurime, Shërbime profesionale, shkencore dhe teknike, etj.

Rreth 89% e të anketuarve jetojnë në qytet dhe shumica prej tyre janë banorë të Prishtinës. Kjo tregon për një qendër të aktivitetit ekonomik në kryeqytet.

Rreth 80% e të anketuarve mendojnë se liberalizimi i vizave do të ketë ndikim në tregun e punës në Kosovë. Disa shohin këtë si një mundësi për të gjetur punë në vende të tjera evropiane, ndërsa disa shqetësohen për konkurrencën dhe rrezikun e largimit të fuqisë punëtore të kualifikuar (brain drain).

Arsyeja kryesore e udhëtimit në vendet e BE është turizmi, ndërsa një përqindje e konsiderueshme e anketuarve mendon se do të udhëtojnë për vizita familjare apo edhe për vende pune.

Rreth 21% e të anketuarve do të udhëtojnë për herë të parë në vendet e BE-së, duke treguar një ndikim pozitiv të liberalizimit të vizave në lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës. Një përqindje e mirë e anketuarve janë të informuar dhe të vetëdijshëm për rregullat e udhëtimit pa viza dhe qëndrimin afatshkurtër në BE.

Duke u bazuar në të dhënat e studimit, duket se liberalizimi i vizave do të ketë ndikim në tregun e punës në Kosovë. Një pjesë e të anketuarve e shohin këtë si një mundësi për të gjetur punë në vende të tjera evropiane apo edhe përmirësimin e kushteve të punës në vend përshkak të investimeve të jashtme potenciale, ndërsa të tjerët shqetësohen për konkurrencën dhe ndikimin potencial në tregun e punës në Kosovë. Është e rëndësishme që autoritetet dhe institucionet e Kosovës të kenë parasysh këto faktore dhe të marrin masa për të përballuar sfidat dhe për të përdorur mundësitë që liberalizimi i vizave sjell për zhvillimin e tregut të punës në vend.

Mirënjohje

I falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit e sondazhit për kohën dhe kontributin e tyre të çmuar.

Falenderime të veçanta për studentët nga Kolegji Pjetër Budi për ndihmën tyre në mbledhjen e të dhënave. Ekipi i The Headhunter në përgatitjen e raportit dhe analizimin e rezultateve. Puna e jashtëzakonshme e Sabedin Mehës në vizualizimin e rezultateve përmes Power BI.